



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT  
TË INDUSTRIJËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIJËS

Nr. 6638/Prot.  
2

Tiranë, më 20.09.2021

**Lënda:** Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1849, datë 23.10.2017.

**Drejtuar:** SHOQERISË “VELLAZERIA MINERALS ALBANIA” SHPK  
SHESI RILINDJA, KOMPLEKSI KARL TOPIA, KULLA 2, KATI 2,  
TIRANË

**Për dijeni:** AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE  
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË  
MINIERA

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “VELLAZERIA MINERALS ALBANIA” sh.p.k, është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1849, datë 23.10.2017, për mineral kromi, në objektin “Kepenek Fshat”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.2161, datë 02.06.2021 (Nr.4638, Prot. MIE datë 03.06.2021), është propozuar revokimi i Lejes së Shfrytëzimit Nr.1849, datë 23.10.2017, për mineral kromi, në objektin “Kepenek Fshat”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës, **sepse në objekt nuk punohet për me shume se një vit kalendarik si dhe nuk keni miratuar programin vjetor të punës në AKBN.**

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në nenin 47, pika 1, gërma “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe ndryshimet e tij Nr.134/2014 datë 09.10.2014.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen minerare të Nr.1849, datë 23.10.2017, për mineral kromi, në objektin “Kepenek Fshat”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit Nr.1849, datë 23.10.2017, për mineral kromi, në objektin “Kepenek Fshat”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI**  
**BELINDA BALLUKU**  
**ME AUTORIZIM**  
**ZËVENDËSMINISTRI**  
**ILIR BEJTJA**

